



Pranuar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Delivered	17.08.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlyerja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHOK	5708	2023	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.909/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrta i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.909/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesja _____, me adresë _____

_____ kundër organit të punësimit/Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 17.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. **Detyrohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesën e datës 11.05.2023 të ankueses dhe për të njëjtën të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë që të kujdeset që ky vendim të zbatohet si në pikën I.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED] është e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Akt emërimit me numër Nr-076 të datës 10.12.2012 në pozitën e punës "Asistente Administrative" në Departamentin e Menaxhimit Stratexhik. E njëjta sipas vendimit me numër Nr.93/17 të datës 23.08.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë është caktuar si Sekretari e Komisionit për ankesa të shkallës së dytë. Po ashtu sipas vendimit me numër Nr.72/IV/2023 të datës 05.04.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë është caktuar si Sekretari teknike e Bordit për Shkollim Specialistik.

Ankuesja me datë 11.05.2023 i është drejtuar me shkresën Informatë (Kërkesë), Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila kërkon të kompenzohet për vëllim të madh të punës në bazë të Rregullores (QRK) nr.08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik bazuar në nenin 6 dhe 7 njësoj sikurse bëhet për të gjithë anëtarët e Bordit për Shkollim Specialistik. E njëjta nuk ka marrë përgjigje nga ana e institucionit lidhur me shkresën e saj.

Ankuesja më datë 05.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5015/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore e cila kërkon të kompenzohet për vëllim të madh të punës në bazë të Rregullores (QRK) nr.08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik bazuar në nenin 6 dhe 7 njësoj sikurse bëhet për të gjithë anëtarët e Bordit për Shkollim Specialistik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.07.2023 përmes e-mailit ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa Këshilli më datë 24.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 5015/2023 të datës 05.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Informatë e datës 11.05.2023; E-mail nga F.M. për M.B. i datës 08.06.2023; E-mail nga M.B. për N.B. i datës 08.06.2023; Akt Emërim i F.B. i datës 10.02.2012; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.07.2023; E-mail nga C.Z. për H.S. i datës 20.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 24.07.2023; Përshkrimi i Punës për pozitën "Assistent Administrativ"; Vendim për formimin e komisionit për ankesa i shkallës së dytë për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve për specializim dhe të specializantëve me numër protokolli 05-6343 i datës 23.08.2017; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkallës së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur datë 22.05.2023; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkallës së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur datë 18.05.2023; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkallës së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur datë 12.05.2023; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkallës së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur pa datë; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkallës së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur

datë 18.04.2023; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkalles së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur datë 14.04.2023; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkalles së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur datë 13.04.2023; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkalles së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur datë 02.03.2023; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkalles së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur datë 01.03.2023; Mbledhja e Komisionit për ankesa e shkalles së dytë në Departamentin për Menaxhimin Strategjik Ministria e Shëndetësisë e mbajtur datë 07.03.2023; Vendim me numër protokollit 05-2138 i datës 05.04.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 14.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 14.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 07.07.2023; Procesverbali nga mbledhja e bordit për Shkollim Specialistik i datës 07.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 05.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 05.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 04.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 04.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 03.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 03.07.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 16.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 16.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 15.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 15.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 14.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 14.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 13.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 13.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 12.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 12.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 09.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 09.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 07.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 07.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 06.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 06.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 05.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 05.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 02.06.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 02.06.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 25.05.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 25.05.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 19.05.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 19.05.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 15.05.2023; Bordi për Shkollim Specialistik (BSHS) mbledhje e mbajtur datë 15.05.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 12.05.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 12.05.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 05.05.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 05.05.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 28.04.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 28.04.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 14.04.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 14.04.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 12.04.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 12.04.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 04.04.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 04.04.2023; Bordi për

Shkollim Specialistik e mbajtur datë 27.03.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 27.03.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 07.04.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 05.04.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 31.03.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 31.03.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 28.03.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 17.03.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 17.03.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 10.03.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 10.03.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 03.03.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 03.03.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 24.02.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 24.02.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 16.02.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 16.02.2023; Bordi për Shkollim Specialistik e mbajtur datë 10.02.2023; Procesverbali nga mbledhja e Bordit për Shkollim Specialistik e datës 10.02.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka konstatuar se meqenëse nuk është shqyrtuar kërkesa/informata e datës 11.05.2023 nga organi kompetentë atëherë detyrohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë që të shqyrtoj dhe nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, *sepse*:

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se ankuesja më datë 11.05.2023 ka parashtruar Informatë/Kërkesë (por përkundër që emërtohet si informatë por se në funksion të qëllimit të parashtrimit të kësaj shkrese nga ankuesja e njëjta nga kolegji trajtohet si kërkesë), tek Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë përmes të cilit ka kërkuar që të kompenzohet për vëllim të madh të punës në bazë të Rregullores (QRK) nr.08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik bazuar në nenin 6 dhe 7 njësoj sikurse bëhet për të gjithë anëtarët e Bordit për Shkollim Specialistik. Mirëpo e njëjta nuk i ka kthyer përgjigje lidhur me shkresën e ankueses të lartëcekur.

Kolegji i Këshillit, lidhur me obligimin e organit publik që të shqyrtoj në mënyrë të drejtë Informatën (kërkesën) dhe të nxjerr akt administrativ, ju referua Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: "3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar", nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: "1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës", nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: "1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative", si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit ndërlidhur me kuadrin ligjor të cekur si më lartë, konstaton faktin se Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, është i obliguar që të shqyrtoj Informatën (kërkesën)

e datës 11.05.2023 të parashtruar nga ankuesja me të gjitha pretendimet, dhe njëkohësisht të nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe të njëjtin ta arsyetoj sipas dispozitave të nenit 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të këtij ligji gjithnjë duke ju referuar afatit kohorë të përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.909/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.